

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi del me deklaratë të përbashkët për dënimin në Hagë: Nuk mund të barazohet agresori me viktimën
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/kuvendi-del-me-deklarate-te-perbashket-per-denimin-ne-hage-nu-k-mund-te-barazohet-agresori-me-viktimen/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:29:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:27:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5272428b5bef18e4b05a14466abfab1a07ba07fa903e9eb5241dcb4883dca6a
TEKSTI	84d0f439b9690b782df6f790beb8268f6953fc70449276523dbdfc3fe6c33f18
PAMJA	e7515aa33fafd159f66a6309ea260f5b14f88605e47c296af751b3e60f4dd46f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1d0b63cdd250507b70eb89ffd1c07f13ef4860764d03a5cdfbe3a3b1c9455257
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1d0b63cdd250507b70eb89ffd1c07f13ef4860764d03a5cdfbe3a3b1c9455257>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kuvendi del me deklaratë të përbashkët për dënimin në Hagë: Nuk mund të barazohet agresori me viktimën

LAJME E ENJTE, 17 SHTATOR 2026 15:27



Kuvendi i Shqipërisë ka dalë me një deklaratë të përbashkët, pas vendimit të djeshëm të gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së, të cilët u dënuan me 81 vite burg total.

Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi theksoi se një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli dhe as të barazojë agresorin me viktimën.

**Deklarata e plotë:**

Kuvendi i Shqipërisë shpreh indinjatën e thellë dhe mosdakordësinë e plotë me një vendim që e konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi i Shqipërisë rithekson një të vërtetë historike që nuk mund të relativizohet: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ishte lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përndjekjes dhe për të fituar të drejtën për të jetuar të lirë në vendin e vet. Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit sistematik, dhunës, spastrimit etnik dhe genocidit të kryer nga regjimi i Slobodan Milosheviçit. Pa luftën dhe sakrificën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pushtimit gjakatar serb, historia e çlirimit të Kosovës nuk mund të kuptohet. UÇK-ja ishte forcë vendimtare e rezistencës së popullit të Kosovës dhe e rrugës që çoi drejt çlirimit, lirisë dhe pavarësisë së saj. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga lufta për çlirim dhe nga rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetësisë së saj.

Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën. Nuk mund të zhbëjë sakrificën e UÇK-së.

Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për standardet e dyfishta në trajtimin e së kaluarës së përgjakshme të rajonit. Nderimet publike dhe shtetërore që u rezervohen personave të dënuar për krime lufte, si edhe glorifikimi i figurave të lidhura me genocidin dhe spastrimin etnik përfshirë Ratko Mladicin, cenninë kutesën e viktimave, pengimin e natimit dhe

LAJMET KRYESORE

Ministria Spahiu në Kuvend:
Në janar 2027 sjell Pet Scan-in tek Onkologjiku ose jap dorëheqjen!



Përplasje në protestë,
qytetarët bllokojnë rrugët.
Disa të shoqëruar



Nikoll Lesi: Pabesia e Hagës,
dënoi aleatët që Perëndimi i
përdori kundër Millosheviçit



Kosovë: Reagime pas
dënimeve ndaj ish-krerëve të
UÇK-së. Goditen ambasadat e
huaja në Prishtinë




Deputetja Sala Jashari:
Kuvendi i Kosovës duhet të
nisë procedurat për zhbërjen
e Gjykatës Speciale të Hagës

TË PËRZGJEDHURA

Edmond Spaho te Nikoll Lesi:
PD ka mbaruar, nuk vjen ne
pushtet!



Luka Modric konfirmon
pjesëmarrjen me Kroacinë në
Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe
blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-
autonom drejt përshtatjes me
rregullat evropiane, thotë
Franca



Shpërthen Erion Braçe te
Nikoll Lesi në KOHA JONË-
DEBAT: Nuk votoj kandidat
me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

bien ndesh me vlerat europiane.

Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Miloševićit dhe për të delegjitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë qëndron në solidaritet të plotë me Kosovën, popullin dhe institucionet e saj, si dhe pranë Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe familjeve të tyre.

E palëkundur mbetet bindja jonë në pafajësinë e tyre dhe po aq e palëkundur mbetet e vërteta historike: UÇK-ja luftoi për lirinë dhe çlirimin e Kosovës.

Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Kuvendi pret që të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e mëtejshme të procesit të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që:

Në të gjitha forumet ndërkombëtare të denoncojë krimet e regjimit serb të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përfshirë aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale gjatë luftës; të kërkojë drejtësi për viktimat dhe të dënojë mungesën e angazhimit të autoriteteve serbe për zbardhjen e këtyre krimeve, vendosjen e përgjegjësisë dhe garantimin e drejtësisë për viktimat.

Të koordinojë veprimet me Kuvendin e Kosovës, dhe i bën thirrje të dyja Qeverive tona që gjithashtu të koordinojnë veprimet, me qëllim korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale.

MË SHUMË NGA LAJME



Berisha: Vuçiç dhe Edi Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi ...



Kumbaro: Shqipëria mirëpret Bordin e PISA-s për herë të parë në Tiranë



Tensione pranë ministrit të Brendshme, protestuesit godasin me vezë ...



PD kërkon heqjen nga rendi i ditës të "Statusit të Magjistratëve": S'...



Peleshi në Kuvend: Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, një vendim i dhimb...



Deputetët në seancë, qytetarët mbledhen te Parlamenti. Policia vendos...

LAJMET E FUNDIT



Kuvendi del me deklaratë të përbashkët për dënimin në Hagë: Nuk mund të barazohet agresori me viktimën

[2 MINUTA MË PARË](#)



Amorim dhe Spalletti në presion, Conte prit të jetë sonte në stadium edhe në Torino

[6 MINUTA MË PARË](#)



Kundërshtoi pezullimin e afateve të paraburgimit, Apeli rrëzon kërkesën e ish-presidentit Meta

[52 MINUTA MË PARË](#)





“Dyfisho Sipërmarrjen Tënde”, Ibrahimaj: 1700 biznese kanë shfaqur interes për të përfutur financim

[1 ORË E 9 MINUTA MË PARË](#)



Ministria Spahiu në Kuvend: Në janar 2027 sjell Pet Scan-in tek Onkologjiku ose jap dorëheqjen!

[1 ORË E 39 MINUTA MË PARË](#)



Protestuan në zonën e Zogut të Zi, Gjykata e Tiranës liron personat e arrestuar

[2 ORË E 14 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta **"KOHA JONË"** themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.